



Informatat dhe kërkesat për të aplikuar për vizë C Shengen

Njoftim i rëndësishëm: Nga 1 gushti 2018 terminet duhet të rezervohen online përmes faqes së internetit të kompanisë TLScontact <https://ch.tlscontact.com/xk/prn/index.php> (Vini re: deri më dhe me 30 korrik 2018 terminet duhet të rezervohen përmes faqes së internetit të Ambasadës Zvicerane si deri tani. Me datën 31 Korrik 2018 nuk do të mund të rezervohen terminet.)
Nga 3 shtatori 2018 të gjithë kandidatët duhet ta dorëzojnë kërkesën e tyre për vizë personalisht në kompaninë TLScontact në adresën e mëposhtme: TLScontact, Ahmet Krasniqi, Objekti C1-1, Nr.145, kati përdhësë, Arbëri / Dragodan. Asnjë dokument nuk bën të dërgohet me faks apo me email në ambasadë.

KËRKESAT E PËGJITHSHME

- Personi që kërkon vizë duhet të paraqitet personalisht
- Kërkesa e nënshkruar nga aplikuesi (pas plotësimit të aplikacionit online, duhet të shtypet dokumenti i formatit PDF)
- 2 fotografi me ngjyra të madhësisë së fotografisë për pasaportë, jo më të vjetra se gjashtë muaj, të cilat janë në përputhje me specifikacionet ICAO
- Pasaporta e vlefshme edhe 3 muaj pas lëshimit të zonës Shengen me të paktën edhe 2 faqe të lira.
- 1 kopje e pasaportës ose e dokumentit të udhëtimit (faqja me fotografi, të dhëna personale dhe nënshkrim)
- Kopjet e vizave të mëhershme (nëse ka të tilla)
- Certifikatat origjinale të gjendjes civile, jo më të vjetra se 6 muaj: certifikata e lindjes, e martesës, e vdekjes dhe deklarata e bashkësisë familjare
- Dëshmia për posedimin e mjeteve të mjaftueshme për jetesë:
 - Gjendja e xhirollogarisë bankare për 6 muajt e fundit ose dëshmia e të ardhurave të rregullta, p.sh. raporti i pagave për 6 muajt e fundit
- Për të punësuarit:
 - Kontrata e punës dhe konfirmimi i pushimit nga punëdhënësi me përkthim në njërën nga gjuhët zyrtare në Zvicër (D, F, I) ose në gjuhën angleze.
 - Dëshmia e pagesës së kontributeve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për gjashtë muajt e fundit apo vërtetimi tatimor mbi pagesën e tatimit
- Për pronarët e firmave:
 - Certifikata e regjistrimit të biznesit
 - Vërtetimi tatimor i kompanisë në Kosovë nga Administrata Tatimore
- Për bujqit:
 - Dëshmia e posedimit të pronës
- Për pensionistët:
 - Vërtetimi i pensionit
- Për nxënësit / studentët:
 - Vërtetimi nga shkolla / universiteti
 - Kartela e studentit; indeksi i nënshkruar dhe i vulosur nga universiteti dhe transkripti i notave aktuale (shtypur nga sistemi elektronik i fakultetit përkatës)
 - Dëshmia e qëndrueshmërisë financiare të prindërve (p.sh. kontrata e punës apo pasqyra bankare) ose dëshmia e posedimit të fondeve të mjaftueshme për tërë qëndrimin, apo ofrimi i ndonjë garancie
- Sigurimi shëndetësor për udhëtim për kohën e qëndrimit jashtë vendit (i pranueshëm në zonën Shengen). Sigurimi duhet të ketë mbulesë së paku EUR 30'000.00 + informatat për kushtet e përgjithshme të sigurimit duhet bashkangjitur.
- Pagesa për vizë me para të gatshme (60€ për të rritur, 35€ për fëmijë 6-12 vjeç dhe pa pagesë për fëmijët nën moshën 6 vjeçare - Ju lusim që ta sillni shumën e saktë) & dhe tarifën e shërbimeve të TLScontact-it (prej 3 shtatorit 2018)
- **Nëse aplikuesi është i mitur/nën moshën 18 vjeçare dhe udhëton vetëm, me njërin prind ose me kujdestarin ligjor:** të dy prindërit ose kujdestarët ligjorë duhet të jenë të pranishëm kur dorëzohet aplikacioni për vizë. Mund të bëhet përjashtim nga kjo për prindin i cili e ka të drejtën e vetme të kujdestarisë ndaj fëmijës. Prindi që gëzon kujdestarinë e vetme ndaj fëmijës duhet të paraqesë një dokument zyrtar, i cili dëshmon se ai/ajo është prindi i vetëm p.sh. certifikatën e vdekjes, marrëveshjen e shkurorëzimit ose marrëveshjen për kujdestarinë ndaj të miturit.

Vizitë private (familjare)

- Kërkesat e përgjithshme (të lartë përmendura)
- Dëshmia e sponsorimit dhe/ose akomodimit privat: një ftesë e nënshkruar nga të gjithë garantuesit (në anglisht, gjermanisht, frengjisht ose italisht), kopjet e pasaportave të garantuesve (faqja me foto, të dhëna personale dhe nënshkrim) nëse garantuesit janë shtetas zviceran. Në rast se kanë nënshtetësi tjetër duhet të dorëzohen kopjet e pasaportave edhe kopjet e lejeqëndrimeve të tyre.

Për shtetet në vijim duhet të dorëzohet edhe dokumenti i cekur në tabelë:

Francë	Dokumenti origjinal "Declaration d'Accueil" i lëshuar nga autoritetet frënge në komunën e garantuesit.
Austri	Garantuesi duhet të kërkojë një "Elektronische Verpflichtungserklärung" në komunën e vet në Austri. Për më shumë informata: http://www.bmi.gv.at/202/Fremdenpolizei_und_Grenzkontrolle/Einreise/start.aspx#eve Garantuesi duhet t'ua dorëzojë "Elektronische Verpflichtungserklärung" autoriteteve austriake jo më herët se 30 ditë para datës së terminit të caktuar për aplikim për vizë.
Belgjikë	Dokumenti origjinal « Engagement de Prise en Charge - Verbintenis tot Tenlasteneming 3 bis » me vulë të komunes përkatëse dhe me pullë të thatë nga zyra për të huaj.
Holandë	Dokumenti origjinal Bewijs van Garantstelling, tri raporte / dëshmi të pagave dhe kontrata e punës së garantuesit. Në rast se garantuesi është i vetpunësuar: certifikata e biznesit të garantuesit; aktvendimi për tatim ("down aanslag inkomstenbelastingen" aktuale, pasqyra vjetore e Administratës Tatimore „Belastingdienst“) dhe kopjen e bilancit të fitimit dhe humbjes



Luksemburg

Dokumenti original « Engagement de prise en charge » i lëshuar nga autoritetet të Luxemburgut në komunën e garantuesit.

Vizë turistike

- Kërkesat e përgjithshme (të përmendura më parë)
- Dëshmia e akomodimit (p.sh. konfirmimi i rezervimit të hotelit) dhe detajet rreth rezervimit (p.sh. plan i udhëtimit)

Vizë afariste

- Kërkesat e përgjithshme (të përmendura më parë)
- Kërkesa me shkrim nga kompania/organizata ftuese, me vulë zyrtare dhe nënshkrim të kompanisë
- Dëshmia e sponsorimit dhe/ose akomodimit privat
- Për gazetarë:
 - Vërtetimi i lëshuar nga organizata profesionale
 - Dokument nga punëdhënësi ku ceket qëllimi i udhëtimit
- Për shoferët e autobusëve:
 - Vërtetimi i hollësishëm i itinerarit (orari, ndalesat dhe kohëzgjatja, leja e vlefshme)
 - Dëshmia e marrëdhënies afariste (dëshmia përmes certifikatës dhe informatave të regjistrimit të biznesit, kontratave të bashkëpunimit, faturimeve)

Vizë për trajtim mjekësor

- Kërkesat e përgjithshme (të përmendura më parë)
- Akomodimi (nëse aplikuesi nuk do të qëndrojë në spital gjatë tërë kohës së trajtimit):
 - Konfirmim nga institucioni që e siguron akomodimin (p.sh. rezervimi i hotelit)
 - Nëse akomodimi sigurohet nga ndonjë person privat: një ftesë e nënshkruar nga të gjithë garantuesit (në anglisht, gjermanisht, frengjisht ose italisht), kopjet e pasaportave të garantuesve (faqja me foto, të dhëna personale dhe nënshkrim) nëse garantuesit janë shtetas zviceran. Në rast se kanë nënshetësi tjetër duhet të dorëzohen edhe kopjet e lejeqëndrimeve të tyre **[shiko tabelën më lartë, pika Vizitë private (familjare)]**
- Konfirmim zyrtar për trajtim/termin nga institucioni mjekësor pranues
- Dëshmia e posedimit të mjeteve të mjaftueshme financiare për ta paguar trajtimin mjekësor dhe shpenzimet tjera përkatëse
- Vërtetimi nga mjeku dhe/ose spitali në Kosovë, që tregon se është i nevojshëm trajtimi mjekësor dhe që duhet ndërmarrë jashtë vendit
- Dëshmia e parapagimit të trajtimit

Vizë për aktivitete kulturore, sportive apo edukative

- Kërkesat e përgjithshme (të përmendura më parë)
- Një kërkesë me shkrim nga organizata ftuese
- Konfirmimi i rezervimit të hotelit apo i vendqëndrimit
- Në qoftë se qëndroni tek një person privat duhet ta sillni edhe: një ftesë e nënshkruar nga të gjithë garantuesit (në anglisht, gjermanisht, frengjisht ose italisht), kopjet e pasaportave të garantuesve (faqja me foto, të dhëna personale dhe nënshkrim) nëse garantuesit janë shtetas zviceran. Në rast se kanë nënshetësi tjetër duhet të dorëzohen edhe kopjet e lejeqëndrimeve të tyre **[shiko tabelën më lartë, pika Vizitë private (familjare)]**
- Për aktivitete artistike, kulturore dhe arsimore: kërkesa me shkrim nga kompania/organizata ftuese, me vulë dhe nënshkrim të kompanisë/organizatës, e cila përmban këto informata:
 - Datat e sakta të qëndrimit të planifikuar dhe adresa e banimit në vendin mikpritës
 - Vërtetimin e regjistrimit të organizatës në vendin mikpritës
 - Vërtetimi për mbulimin e shpenzimeve gjatë vizitës
- Për pjesëmarrësit në aktivitete sportive:
 - Fotokopjet e të gjitha faqeve të kartelës së regjistrimit në federatën e sportit
 - Ftesën nga klubi/federata organizative në vendin mikpritës
 - Vërtetimi nga klubi/federata e sportit që e dërgon sportistin
 - Dëshmia e pagesës së tarifës së regjistrimit në atë manifestim/turne
- Nëse aplikuesi është artist:
 - Dëshmia e kualifikimit (p.sh. dëshmia e anëtarësisë në ndonjë asociacion profesionist, kontrata me menaxherin, etj)
 - Vërtetimi i lëshuar nga organizatori lidhur me manifestimin, ku shënohen data, vendi dhe numri i performancave

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane:

- Nuk pranon aplikacion pa termin të caktuar.
- Nuk jep informata përmes telefonit apo emailit në lidhje me arritjen e përgjigjes për vizë.
- Ka të drejtë:
 - të kërkojë dokumente shtesë
 - ta dërgojë aplikacionin për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër
 - t'i thërrasë aplikuesit për një intervistë
 - ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak